

Kosova: Shtërpce, model i enklavës serbe?

I. PËRMBLEDHJE

Shtërpce, një nga enklavat më të mëdha në Kosovë dhe një nga të rrallat me marrëdhënie të mira në mes serbëve dhe shqiptarëve dhe me perspektiva ekonomike, rrezikon që të bie viktimë e përlëshjes mbi statusin ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës. Por në të njëjtën kohë ka shansë që t'u demonstrojë serbëve se ata mund të mbrojnë interesat e tyre brenda rendit kushtetues të Kosovës. Që nga maji 2008, komuna është qeverisur nga autoritete konkurruese me njëra tjetrën, të dyjat të udhëhequra nga serbët: një pushtet zyrtar të emëruar nga OKB-ja përkundër kundërshtimit lokal, dhe një regjim paralel të zgjedhur duke sfiduar ligjin e Kosovës. As njëri as tjetri nuk kanë kapacitet që të kryejnë detyrat e veta. Kjo bllokadë e ka privuar këtë enklavë të qetë nga një pushtet efektiv dhe ka shkatërruar ekonominë e saj, duke parandaluar rregullimin e tregut të saj atraktiv të pronave dhe duke bllokuar privatizimin e qendrës për skijim në Brezovicë. Zgjedhjet lokale më 15 nëntor 2009 mund të sjellin në përfundim këtë status quo, t'i japin Shtërpces një pushtet legjitim dhe të zhbllokojnë potencialin e saj ekonomik. Beogradi, Prishtina dhe komuniteti ndërkombëtar duhet të inkurajojnë daljen në votim dhe të pajisin qeverinë komunale me pushtetin dhe resurset për të cilat ka nevojë.

Për një kohë të gjatë Beogradi i ka konsideruar serbët e Kosovës si instrument me të cilin mund të vihet në dyshim pavarësia e Kosovës, duke sponsorizuar zgjedhjet paralele nën ligjin serb dhe duke ofruar përkrahje ekonomike substanciale. Mirëpo Serbisë i mungon aftësia për të ofruar shërbime të mirëfillta qeveritare në enklavat jugore siç është Shtërpce. Pushteti komunal paralel ofron një numër të vogël shërbimesh për banorë dhe çdo herë e më shumë po bëhet jorelevant për jetën e tyre të ditëpërditshme. Serbia duhet të vendosë në rend të parë interesat e banorëve të Shtërpces dhe të pranojë dhe njohë faktin se atyre u duhet të kenë një lidhje me autoritetet e Prishtinës. Duke përkrahur një komunë multi-etnike, Beogradi do të vazhdojë të luajë një rol në institucionet të cilat janë të rëndësishme për serbët lokalë, siç janë edukimi dhe shëndetësia, derisa njëkohësisht kjo do t'u ofronte banorëve mundësinë që të fokusoheshin në gjërat e përditshme të cilat janë të rëndësishme për ta.

Qeveria e Kosovës me ngadalësi po i ofron Shtërpces dhe komunave të tjera pushtetin e theksuar dhe kompetencat të cilat janë të parapara me planin e Ahtisaarit, dokumenti kornizë ky i zhvilluar nga Martti Ahtisaari, ish-presidenti i Finlandës, i shkruar në kohën kur ai tentoi të ndërmjetësonte mbi çështjen e mosmarrëveshjes mbi statusin si përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, para se ky territor të deklaronte pavarësinë. Prishtina insiston se decentralizimi duhet të shtrihet në enklavat jugore si dhe në veriun radikal serb, pjesërisht për t'iu shmangur çfarëdo precedentit që do të përforconte planet për ndarje. Shumë veta në qeveri e konsiderojnë decentralizimin si shpërblim, jo si të drejtë, dhe presin nga serbët e Kosovës që të pranojnë autoritetin e pushtetit qendror në mënyrë eksplicite, para se ai pushtet të transferohet në komunat e tyre. Dalja e një numri të ulët të serbëve në zgjedhje, sipas këtij mendimi, do të ishte justifikim për vonesë të mëtejshme në implementimin e decentralizimit.

Disa parti serbe do të marrin pjesë, por pa pjesëmarrjen e partive të mëdha dhe me bazë në Serbi, dalja në zgjedhje mund të jetë tepër e vogël për të prodhuar një rezultat elektoral në përputhje të plotë me demografinë aktuale dhe preferencat politike. Në një rast të tillë, Prishtina duhet të veprojë për të mundësuar një pushtet komunal, të bashkuar dhe multi-etnik:

- Në rrethana të tilla, ministria e pushtetit lokal duhet të emërojë një administrator (kryetar) serb në nivelin lokal, si dhe një asamble të re komunale, të përbërë nga kandidatët e regjistruar serbë dhe shqiptarë. Kjo do ta pajiste Shtërpccen me një pushtet komunal me të vërtetë përfaqësues, edhe pse në këtë pushtet vetëm shqiptarët mund të kenë demonstruar kredencialet e tyre duke pranuar një mandat të mirëfilltë elektoral nga votuesit e vet. Mirëpo mandati i të zgjedhurve serbë, tashmë i shtyrë një herë, nuk ka legjitimitet dhe nuk duhet të shtyhet përsëri.
- Qeveria e Kosovës duhet pastaj që t'i besojë komunës së re kompetencat e theksuara dhe mjetet e tjera për të cilat ajo ka nevojë, në mënyrë që ajo të mund të menaxhojë Shtërpccen në emër të të gjithë banorëve të saj.

Themelimi i një pushteti komunal legjitim dhe efektiv do të ofronte siguri për Shtërpccen që ajo të merret në mënyrë efektive me çështjet e saj kryesore - Brezovicën (destinacionin turistik më të njohur të Kosovës) dhe Zonën e

Vikendit, me patundshmëri të nivelit të parë në zemër të Parkut Nacional të Sharrit. Qendra për skijim e Brezovicës ka disa nga vendet për rrëshqitje më të mira në Evropë; me një zhvillim të mirëfilltë, ajo do të nxiste rritje ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës në tërë rajonin lokal. Privatizimi dhe zhvillimi kanë stagnuar për më shumë se një dekadë si rezultat i mosmarrëveshjeve mbi pronat dhe akuzave për korrupsion; është i nevojshëm një lidhshmëri e freskët lokal.

Pasi që ministria për ambient dhe planifikim hapsinor (MAPH) të ketë përgatitur një plan gjithëpërfshirës për përdorimin e tokës dhe pas aprovimit të tij nga komuna, qendra për skijim duhet të vendoset në treg. Çfarëdo pohimesh mbi pronat nga kompanitë serbe mund të zgjidhen nga dhoma e veçantë e privatizimit e Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila përbëhet nga një shumicë e gjykatësve ndërkombëtarë.

Nevojitet po ashtu edhe një qasje e re për Zonën e Vikendit, ku janë ndërtuar me qindra vila luksoze, shumë prej tyre ilegalisht, brenda parkut nacional. Kontrolli mbi ndërtimet ka qenë një nga përparësitë më lukrative të të dyja pushteteve të tanishme komunale. Paaftësia për të mbajtur rend në Zonën e Vikendit dëmton kredibilitetin, dëmton ambientin dhe e privon komunën nga të ardhurat tatimore për të cilat ka nevojë aq shumë. Rrëzimi i ndërtimeve ilegale nuk është përgjigje. Në vend të kësaj:

- autoritetet e reja komunale duhet të imponojnë dënime të rrepta mbi pronarët dhe të legalizojnë shtëpitë ekzistuese, duke parandaluar njëkohësisht ndërtime të mëtejshme; dhe
- nëse është e domosdoshme, EULEX-i, misioni i Bashkimit Evropian për përforcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, duhet të përdorë autoritetin e vet për të hetuar dhe ndjekur korrupsionin.

Progresi në Shtërpce me siguri do të kishte ndikim katalizues mbi decentralizimin nëpër tërë Kosovën. Komuna mund të shërbejë si model drejt së cilit duhet të punojnë edhe komunat e tjera me shumicë serbe. Me bojkotimin e decentralizimit nga Beogradi, ndërsa me një Prishtinë në dukje të painteresuar në këtë proces, zhvillimet e dukshme dhe në terren janë basti më i sigurt për të bindur serbët skeptikë se ata kanë një të ardhme në Kosovë.

II. DY PUSHTETE, NJË QYTET

Shtërpce është një komunë malore në pjesën jugor të Kosovës, në kufi me Maqedoninë. Përbëhet nga gjashtëmbëdhjetë fshatra, përfshirë këtu edhe qytezën e Shtërpces.¹ Popullata është e përbërë nga 13,600 banorë, prej të cilëve 9,100 janë serbë dhe 4,500 janë shqiptarë.² Komuna po ashtu u ofron strehë 700 deri në 1,000 personave të zhvendosur, shumica syresh nga Ferizaj dhe Prizreni. Është shtëpia e Parkut Nacional të Sharrit dhe vendit për skijim Brezovica, dy rajone këto që përfaqësojnë një pjesë të potencialit ekonomik të Kosovës.

Qyteza e Shtërpces është vendbanimi i një elite substanciale të profesionistëve dhe biznesmenëve serbë. Në të vërtetë, komuna ka më shumë mjekë sesa që ka nevojë, shumica e të cilëve punojnë në klinikën për shëndetësi primare e cila është e mbingarkuar me personel, dhe të cilët marrin paga nga Serbia.³ Fëmijët serbë dhe shqiptarë vijnë shkolla të ndara filllore dhe të mesme.⁴ Në mesin e serbëve, shumica e vendeve shtetërore të punës janë diç më shumë se një formë e ndihmës publike dhe vështrohen nga Beogradi çdo herë e më shumë si një barrë në buxhetin e Serbisë. Sidoqoftë, autoritetet lokale paralele nuk janë duke u munduar të merren me mbingarkimin me personel në institucionet shtetërore serbe. Shumë nga zyrat lokale në Kosovë kanë vende pune me orar gjysmak, ndërsa në Shtërpce

¹ Tetë fshatra janë serbe, katër janë shqiptare dhe katër janë etnikisht të përziera. Për më shumë mbi Shtërpçen në kontekstin e komunitetit serb të Kosovës, shih Raportin për Evropë të Grupit të Krizave Nr 200, *Integrimi i serbëve në Kosovë: ecja përpara me vendosmëri*, 12 maj 2009.

² UNMIK Shtërpce Fact Sheet. Janë po ashtu edhe 37 romë.

³ Sistemi i shëndetësisë përbëhet nga një qendër për shëndetësi primare në Shtërpce dhe tetë nën-qendra, gjashtë nga të cilat shërbehen nga personeli serb; një me personel shqiptar është në Brod/Firrajë; klinika të ndara shqiptare dhe serbe gjenden në të njëjtën ndërtesë në Drajkoc. Përderisa ministria për shëndetësi e Kosovës punëson gjashtëmbëdhjetë anëtarë të stafit mjekësor në Shtërpce, ajo serbe financon më shumë se 300 punëtorë shëndetësorë serbë. Shtërpce ka mjaft specialistë për të përkrahur një institucion të shëndetësisë sekondare; për momentin, raste serioze trajtohen në Graçanicë dhe veri të Mitrovicës (për serbë) dhe Prishtinë (për shqiptarë).

⁴ Shtërpce ka tetëmbëdhjetë shkolla me 2,540 nxënës. Gjysma e shkollave janë serbe, me 1,676 nxënës (547 në shkollim të mesëm). Shkollat shqiptare gjenden në fshatrat me shumicë shqiptare, dhe më e madhja gjendet në Firrajë. Ata numërojnë 864 nxënës (135 në shkolla të mesme). Shkollat serbe kanë më shumë se dyfishin e punëtorëve të shkollave shqiptare – 153 në krahasim me 66 – e vijnë planprogramin serb dhe financohen nga ministria serbe për arsim. Shqiptarët vijnë planprogramin e Kosovës dhe janë nën ministrinë e Kosovës.

një numër i konsiderueshëm i punonjësve të zyrave marrin gjithashtu paga nga ndërmarrjet shtetëore. Në të vërtetë, punësimi shtetëror i financuar nga Serbia është burimi kryesor i të ardhurave për këta banorë.

Buxheti shtetëror i Kosovës, tashmë i rënduar me numër të mbingarkuar të personelit, nuk mund të akomodojë numra të mëdhenj të serbëve të Shtërpces. Zgjidhja e problemit të personelit të mbingarkuar kërkon krijimin e vendeve të punës në sektorin privat. Me një papunësi në mes të 35 dhe 60 përqind, privatizimi i Brezovicës, punëdhënësi i vetëm me mundësi për të punësuar një numër të madh njerëzish, është imperativ.⁵

Marrëdhënjet e mira ndër-etnike mbijetuan luftën e viteve 1998-1999 dhe dhunën e mëvonshme në rajonet përfaqëse. Janë larguar një numër i vogël i serbëve, ndërsa komuna mund të krenohet me përqindjen më të lartë të kthimit të refugjatëve në Kosovë. Shumica serbe konsideron se fqinjët e tyre shqiptarë janë autoktonë në këtë rajon – gjë që është një qëndrim i rrallë. Nuk ka akuza ndaj tyre se “kanë ardhur” nga Shqipëria apo Drenica. Fshatarët shqiptarë nuk kundërshtojnë rolin udhëheqës të serbëve në këtë komunë. Komunitetet ushqejnë lidhje të forta me rajonin dhe ndajnë shpresa për prosperitetin e tij.

Shtërpce mund të luajë një rol kyç si qendër për serbët në jug të Ibrit, disa prej të cilëve kanë përvojë në qeverisjen lokale. Me gjithë faktin se shumica e popullatës serbe të Kosovës është në jug, Mitrovica është bërë qendra e vetme për të gjithë serbët e Kosovës në fushat e arsimit, shëndetësisë dhe financave. Duke qenë se serbët e enklavave janë të pakënaqur me atë që ata e konsiderojnë si pushtet joproporcional në atë qytet,⁶ Shtërpce ka potencialin që të zhvendosë këtë balanc në favor të tyre. Për arsye se gjendet më shumë se 100 km larg Serbisë, shpesh emërohet si “e izoluar”,⁷ mirëpo distanca bën që aty të ketë një qasje më realiste karshi institucioneve të Kosovës sesa në veri, dhe kjo sugjeron se politika e nivelit të lartë mund të mos ndërhyjë edhe aq shumë në çështjet ditore.

Konflikti i viteve 1998-1999 e kishte traumatizuar thellësisht Shtërpçen. Komuna përjetoi relativisht pak luftime dhe shpëtoi me një numër të vogël fatalitetesh, por shumica e shqiptarëve u detyruan të iknin në Maqedoni dhe Shqipëri, dhe u djegën qindra shtëpi të tyre.⁸ Serbët e Shtërpces ia atribuuan këto krime “të

jashtëmve – hajnave paramilitarë nga Serbia, forcave të MUP-it [ministres së brendshme serbe] nga jashtë, si dhe njësiteve të UÇK-së nga Drenica”.⁹ Serbët e dëbuar nga Prizreni dhe Ferizaj kërkuan strehim në Shtërpce. Tensionet pas konfliktit ishin të larta, mirëpo serbët ikën pas okupimit nga NATO-ja, ndërsa Shtërpce mbeti një ishull me një qetësi relative. Administrata e përkohshme e OKB-së (UNMIK-u) shpejt e rikrijoi pushtetin komunal dhe organizoi zgjedhjet, të cilat u bojkotuan nga serbët.¹⁰ Derisa zyrtarët e zgjedhur nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) bëheshin gati të merrnin pozitën e tyre në ndërtesën e komunës, serbët e Shtërpces organizuan protesta masive në qendër të qytetës, duke deklaruar se ata nuk ishin përfaqësues të tyre.

Situata u përmirësua në vitin 2001, kur Nebojsa Çoviçi u bë kryesues i Qendrës Koordinuese për Kosovë (Koordinacioni centar Srbije za Kosovo i Metohiju, KCK) në Beograd. Angazhimi i tij me UNMIK-un çoi deri te pjesëmarrja e vetme masive e serbëve në zgjedhjet në Kosovë – garat parlamentare të vitit 2001 dhe ato komunale të vitit 2002. Ky hap pati një efekt pozitiv në Shtërpce – më në fund u tregua një shans për krijimin e komunës që do të reflektonte demografinë e rajonit, me legjitimitet për t’u marrur me çështje si kthimi i personave të zhvendosur, rindërtimi i pronave të dëmtuara dhe liria e lëvizjes. Regjistrimi i votuesve ishte i suksesshëm, me 17,426 të shënuar si të regjistruar, prej të cilëve 11,771 (67.6 përqind) votuan, pa marrë parasysh bojkotin e të dyja proceseve nga Partia Radikale Serbe ultra-nacionaliste (Srpska radikalna stranka, SRS).¹¹ Nga partitë e mëdha serbe, vetëm Partia Demokratike e Serbisë (Demokratska stranka Srbije, DSS) mori pjesë vetëm; të tjerat u bashkuan në koalicione apo nisma lokale.¹²

Association for the Advancement of Science, American Bar Association Central and East European Law Initiative (Washington DC, 2000).

⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, politikan i lartë serb, Shtërpce, janar 2009.

¹⁰ Intervista të Grupit të Krizave, politikanë serbë, Beograd, Shtërpce, 2008-2009.

¹¹ “Zgjedhjet lokale në Kosovë 2002”, [“Kosovo Local Elections 2002”], OSBE, www.osce.org/documents/mik/2002/11/20461_en.pdf.

¹² Lëvizja për Kosovë e Metohi (Pokret za Kosovo i Metohiju) mori 8.38 përqind të votave; Lëvizja Demokratike serbe (Srpski Demokratski Pokret, SDP) 14.39 përqind; Lëvizja për Ripërtërimin Serbe (Srpski pokret obnove, SPO) 6.76 përqind; Partia Objektive e Kosovës (Kosovska Objektivna Stranka, KOS) 5.72 përqind; Koalicioni për Kthim (Koalicija Povratak) 9.28 përqind; Socialistët e Sirinicka Zhupës (Socialisti siriničke župe, Partia Socialiste e Serbisë e riemëruar, SPS) 18.42 përqind, dhe and DSS 11.65 përqind. Nga partitë

⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar nga Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Shtërpce, maj 2009.

⁶ Raporti i Grupit të Krizave, Integrimi i serbëve në Kosovë, op. cit.

⁷ Intervista të Grupit të Krizave, Mitrovicë/Beograd, 2008/2009.

⁸ “Vrasjet politike në Kosovë, mars-prill 1999”, [“Political Killings in Kosova/Kosovo, March-June 1999”], American

Slaxhan Iliq, figurë e popullarizuar lokale, u zgjodh kryetar i komunës së Shtërpces. Me një vullnet për të tejkaluar ndasitë etnike, ai konsiderohet si personi që kishte krijuar kushtet për kthimin e refugjatëve shqiptarë, si dhe për përpjekjet e tij për të pasur një integrim më të madh në arsim dhe shëndetësi.¹³ Duke dashur që “të mos lejojë që etniciteti të përcaktojë se kush mund të ketë pronë këtu”, ai gjithashtu lejoi pronarët shqiptarë që të ktheheshin dhe të ripararonin pronat e tyre në Zonën e Vikendit.¹⁴ Iliqi arriti rezultate të mira: Shtërpce është akoma komuna më e suksesshme me kthime dhe është një nga vendet e rralla në Kosovë ku institucionet shqiptare dhe serbe të shëndetësisë mund të gjenden në të njëjtën ndërtesë. Kthimi i pronarëve shqiptarë në Zonën e Vikendit çoi deri në rritja e interesit në këtë rajon. Mirëpo ai u kritikua ashpër nga anëtarët serbë të partive të mëdha se ishte i papërvojë dhe se, duke adresuar së pari problemet e shqiptarëve, bëhej jopatriot dhe i marrë.¹⁵ Duke qenë impulsiv dhe emocional, Iliqi dy herë ofroi dorëheqjen e tij, para se të largohej nga pozita në fillim të vitit 2004. Vëzhguesit ndërkombëtarë dhe shqiptarët të Shtërpces tashti e shikojnë administratën e tij me nostalgji si një periudhë të bashkëjetesës multi-etnike.¹⁶

Stanko Jakovljeviq, kryesuesi lokal i Partisë Demokratike (Demokratska Stranka, DS) dhe anëtari i koalicionit Kthimi (Povratak) e zëvendësoi Iliqin si kryetar komune. Më i vjetër dhe më pak aktiv, ai e ndante kohën ndërmjet disa pozitave, duke përfshirë atë të profesorit të universitetit dhe eventualisht edhe atë të koordinatorit të KCK-së për Shtërpce. Kjo i mundësonte atij të kishte të ardhura të shumëfishta, si dhe lojalitete konfliktuoze: si kryetar komune ai operonte brenda kornizës së OKB-së, kurse në pozitat e tjera ai përfundimisht i përgjigjej Beogradit.

Trazirat anti-serbe të marsit 2004 në përgjithësi nuk e prekën Shtërpçen, përveç vrasjes së dy serbëve në fshatin e Drajkocit nga një grup shqiptarësh.¹⁷ Dhuna do t'i largojë serbët nga institucionet e Kosovës dhe theu besimin e tyre; nismat e freskëta lokale për të bashkëpunuar me Prishtinën u ndalën krejtësisht. Politikanët serbë u pozicionuan për së afërmi me partitë e bazuara në Serbi; faza që pasoi krijoi një tension dhe rivalitet brenda elitës

shqiptare, LDK mori 10.93 përqind, PDK 14.14 përqind dhe Partia Socialiste e Kosovës 0.33 përqind.

¹³ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë, Prishtinë, Shtërpce, maj-korrik 2009.

¹⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, Slaxhan Iliq, Shtërpce, 22 maj 2009.

¹⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtarë të DSS-së dhe SRS-së, Shtërpce, 2008-2009.

¹⁶ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtarë ndërkombëtarë dhe politikanë shqiptarë, maj/qershor 2009.

¹⁷ Raporti i Grupit të Krizave për Evropë Nr. 155, *Kolapsi në Kosovë*, 22 prill 2004.

serbe të Shtërpces dhe la Jakovljeviqin të ekspozuar si lider të një partie të vogël lokale dhe të papopullarizuar.¹⁸ Komuna multi-etnike vazhdoi të funksiononte por arriti pakëz, si dhe u duk e paaftë për të ndaluar ndërtime ilegale në Zonën e Vikendit. Thashethëmet për korrupsionin në komunë u përhapën.¹⁹ Jakovljeviqi po ashtu hezitoi të marrë vendim rreth privatizimit të Brezovicës, duke irrituar kështu Prishtinën dhe zyrtarët ndërkombëtarë.²⁰

Eksperimenti në Shtërpce me pushtetin e zgjedhur përfundoi efektivisht me zgjedhjet e nëntorit 2007. E preokupuar me përgatitjet e Kosovës për pavarësi, dhe e udhëhequr nga DSS-ja nacionaliste e Vojisllav Koshtunicës, Serbia bëri thirrje për bojkot. Shumë serbë të Shtërpces ishin të varur nga të ardhurat e institucioneve serbe, ndërsa Beogradi mori hapa për përforcimin e bojkotit, duke përfshirë udhëzimet drejtuar zyrtarëve të KCK-së për të shënuar emrat e kujtdo që do të votonte.²¹ Bojkoti ishte gati plotësisht efektiv: vetëm katërbëdhjetë serbë votuan përkrah fqinjve të tyre shqiptarë.²² Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së (PSSP), Joakim Ryker, refuzoi të certifikonte rezultatet e zgjedhjeve në Shtërpce, duke vazhduar si zëvendësim mandatet e zyrtarëve serbë, duke përfshirë Jakovljeviqin. Kjo e nevríkosi degën lokale të PDK-së, e cila mendonte se fitorja e saj në zgjedhje i jepte asaj të drejtën që të zotëronte zyren e kryetarit të komunës.²³

Kosova shpalli pavarësinë në shkurt 2008. Serbia u përgjigj duke krijuar pushtetet paralele lokale anekënd rajoneve serbe, dhe duke urdhëruar të gjithë serbët në institucionet e Kosovës që të braktisnin vendet e punës. Zgjedhjet që Serbia mbajti në Kosovë më 11 maj 2008 ishin thyerje e qartë e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244, dhe Rykeri menjëherë i shpalli ato ilegale. Megjithatë, dalja në zgjedhje në mesin e serbëve të Kosovës ishte e lartë, ndërsa komunat paralele serbe

¹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, gazetar serb, Shtërpce, maj/qershor 2009.

¹⁹ Pseudonimi i kryetarit të komunës Jakovljeviq – *Deviza* – ka të bëjë me mitot e aluduara mbi ndërtime ilegale. Grupi i Krizave ka dëgjuar shumë njerëz, përfshirë edhe disa nga kolegët e Jakovljeviqit, duke e përdorur këtë pseudonim vazhdimisht.

²⁰ Grupi i Krizave ka parë disa letra të cilat japin e pastaj tërheqin lejen për privatizim, që komuna ia kishte dërguar Prishtinës dhe Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM).

²¹ Vështrim i Grupit të Krizave, nëntor 2007.

²² Numri total ishte 1,597. Komisioni i zgjedhjeve i Kosovës nuk lëshon të dhëna të votuesve sipas etnicitetit, por partitë joshqiptare morën vetëm katërbëdhjetë vota. Rezultatet mund të gjenden në uebfaqen e komisionit, www.kqz-ks.org.

²³ Intervistë e Grupit të Krizave, Ali Halimi, zëvendëskryetar i komunës, Shtërpce, janar 2009.

u shfaqën anembanë republikës.²⁴ Në Shtërpce votuan më shumë se 80 përqind e serbëve lokalë, ndërsa SRS-ja fitoi pjesën më të madhe të ulëseve.²⁵ Në njërin prej shumë episodave të çuditshme, Stanko Jakovljeviq – duke qenë ende kryetar zyrtar i komunës së Shtërpces – po ashtu u kandidua në zgjedhje për pushtetin paralel komunal serb (si kryesues i listës së DS-së) dhe fitoi ulëse në asamblenë komunale.²⁶

Që nga maji 2008 Shtërpce ka pasur, të paktën në letër, dy kryetarë komune, dy kuvende komunale dhe dy pushtete. Në fakt, largimet masive të serbëve e lanë komunën zyrtare pa asamble funksionale.²⁷ Jakovljeviqi, kryetari zyrtar, gjithashtu merr pjesë në asamblenë komunale paralele, e cila funksionon. Rivali i tij, kryetari i komunës paralele Zvonko Mihajloviq, e ka zënë zyrën e kryetarit aktual, duke detyruar Jakovljeviqin që të punojë nga zyra e zëvendëskryetarit.

Komuna zyrtare ka humbur gjysmën e hapësirës së saj të zyrave, por ka mbajtur kontrollin e zyrës kadastrale, e cila është një nga institucionet më të rëndësishme komunale, pasi që aty mbahen të gjitha shënimet mbi pronën lokale, e cila është e përfshirë në të gjitha transaksionet mbi prona dhe lejet për ndërtim. Kështu, mbajtësi i kësaj pozite mund të jetë në vendin e duhur që, nëse dëshiron, të përfitojë nga marrëveshjet nën tavolinë që kanë të bëjnë me Zonën e Vikendit. Komuna zyrtare po ashtu është e përfshirë në dhënjen e dokumenteve të Kosovës, përfshirë këtu edhe regjistrimet e automjeteve të cilat janë të nevojshme për të vozitur jashtë enklavave serbe.²⁸ Banorët shqiptarë të Shtërpces

merren vetëm me komunën zyrtare, në të cilën ata janë të punësuar në disa pozita të rëndësishme, si p.sh. ajo e zëvendëskryetarit.

Komuna paralele ndërmjetëson në mes të serbëve të Shtërpces dhe Serbisë, si dhe luan një rol më të rëndësishëm në jetërat e tyre sesa rivalja zyrtare.²⁹ Ajo merret me programet sociale, prej pensioneve, benefiteve të papunësisë, sigurimeve të shëndetit, si dhe furnizon me dokumente serbe identiteti të cilat janë të domosdoshme nëse nevojitet përdorimi i kushteve mjekësore dhe shkollave të financuara nga Beogradi.³⁰ Shumë banorë marrin ndihma nga Serbia dhe Kosova njëkohësisht, si dhe komunikojnë me të dyja komunat.³¹ Komuna paralele gjithashtu kujdeset për mbarëvajtjen e rrugëve, mbledhjen e mbeturinave dhe relievin e Shtërpces nëpërmjet raportit të saj me kompaninë serbe e cila është e paguar për t'u marrur me këto aktivitete.

Për Prishtinën dhe përfaqësuesit ndërkombëtar atje, komuna paralele nuk është legjitime.³² Përparësia e saj mbi komunën zyrtare është gati plotësisht pasojë e dobësisë së kësaj të fundit; madje edhe një pushtet komunal që është minimalisht funksional shumë shpejt do të tejkalonte strukturat paralele, e cila nuk ka mundësi të plotësojë shumë nga nevojat e Shtërpces. Pa kontakte me qeverinë e Kosovës, për shembull, pushteti paralel nuk mund të lëshojë dokumente që njihen nëpër pjesë të tjera të Kosovës (përveç enklavave të tjera); e as kompanitë nuk mund të regjistrohen me të. Komuna nuk mund të marrë pjesë në planifikime rajonale apo të ketë në dispozicion fonde për zhvillim të rrugëve dhe të infrastrukturës. Aftësia e saj për të stimuluar rritje varet nga donacionet nga Serbia, siç është për shembull çerdhja e fëmijëve nga Këshilli Ekzekutiv i Vojvodinës, i cili pranoi më shumë se 2,000 aplikacione për 50 vende të

²⁴ Për më shumë në zgjedhjet paralele dhe pasojat e tyre, shih Raportin e Grupit të Krizave, *Integrimi i serbëve në Kosovës*, op. cit.

²⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, gazetar serb, Shtërpce, 2 qershor 2008; “Rezultatet e zgjedhjeve lokale në Kosovë”, [“Rezultatit lokalnih izbora na Kosovu”], B92 (online), 16 maj 2008.

²⁶ Kryeministri Hashim Thaqi e vazhdoi mandatin e kryetarit të komunës Jakovljeviq më 3 korrik 2008 nën presionin ndërkombëtar, pas kalimit të një vazhdimi të mëhershëm nga UNMIK-u.

²⁷ Shumë veta morën vende pune në komunën paralele, por disa janë kthyer në komunën zyrtare, për shkak të mungesës së punës gjetiu. Përpjekjet për të ringjallur asamblenë zyrtare komunale kanë dështuar për shkak të presionit nga strukturat paralele; të gjithë kandidatët potencial për asamblenë zyrtare komunale janë tërhequr. Intervista të Grupit të Krizave, politikanë shqiptarë, Shtërpce, Prishtinë, maj-gusht 2009.

²⁸ Disa serbë ngasin makinat me tabela të vjetra e ilegale serbe pa pengesa nëpër Kosovë, por është e kuptueshme se shumë nga ta janë në siklet që të lënë enklavën pa regjistrim legal. Dokumentet e Kosovës, përfshirë dhe pasaportat e reja, lëshohen në fshatin e Drajkocit, për arsye se zyrat janë të zëna nga komuna paralele në qytezën e Shtërpces. Deri në qershor 2009, më shumë se 1,400 serbë kishin aplikuar për

letërnjoftimet e Kosovës. Intervistë e Grupit të Krizave, ministria e brendshme, Prishtinë, qershor 2009.

²⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Shtërpce, janar 2009.

³⁰ Certifikatat e lindjes, vdekjes dhe të martesës, nacionaliteti, rezidenca dhe dëshmia e pronësisë serbe, të gjitha këto mund të pranohen nëpërmjet komunës paralele. Ato lëshohen në Nish dhe Vranje, por qytetarët aplikojnë dhe i marrin dokumentet në komunë. Pasaportët e rinj, biometrikë për banorët e Kosovës tani lëshohen vetëm në qendër të Beogradit, mirëpo është thënë se ata do të përjashtohen nga udhëtimet pa viza të premtuara për qytetarët serbë nga Bashkimi Evropian.

³¹ Pensioni mujor dhe pagesat e shërbimeve sociale nga Beogradi janë 11,000 dinarë (120€). Pagesat ekuivalente të Kosovës janë 40€-80€, por shumë njerëz në Shtërpce i marrin të dyja.

³² Zyrtarët shqiptarë në komunën zyrtare janë më të drejtpëdrejtë: “Zyrtarët e komunës paralele janë hiç më shumë se kriminelë”. Intervistë e Grupit të Krizave, Ali Halimi, Shtërpce, janar 2009.

punës.³³ Ky organ paralel në efekt është diçka më shumë se konsullatë për qeverinë e Beogradit e cila po ashtu ofron pastrime të rrugës dhe shërbime sanitare.

Të dy palët e zyrtarëve janë të aftë për të vepruar në mënyrë pragmatike dhe për të dalur jashtë roleve të tyre formale, kur është nevoja. Zyrtarët dhe autoritetet paralele u ballafaquan në një pikë tensionuese rreth rrymës gjatë korrikut-gushtit 2009. Si shumë enklava serbe, Shtërpce kishte shfrytëzuar rrymën pa paguar me vite të tëra. Kompania e rrymës e Kosovës, KEK-u, më në fund bëri kërkesën për pagesë, ndërsa Serbia refuzoi që të intervenonte, duke i thënë komunës paralele që të paguante. Në pamundësi për t'u takuar me KEK-un në kapacitetin e tyre zyrtar, zyrtarët paralelë e prezantuan veten si "përfaqësues të fshatrave" dhe negociuan me autoritetet e Kosovës, ndërsa kryetari zyrtar mori pjesë në bisedime në kapacitet të dyfishtë – si kryetar zyrtar në takimet me delegacionin e KEK-ut, dhe si zëvendëskryetar në takimet me zyrtarët e komunës paralele. Mbajtja e komunikimit të hapur ndihmoi në zbutjen e një incidenti potencialisht të dhunshëm më 29 korrik 2009, kur një turmë e hidhëruar u tubua pasi KEK-u hyri me forcë në nën-stacionin e Shtërpces dhe dëboi punëtorët serbë nga aty.³⁴

Të gjitha fondet nga Prishtina nën buxhetet për investime kapitale për vitet 2008 dhe 2009 kanë shkuar në projekte për pjesët shqiptare të Shtërpces. Kryetari zyrtar s'para dukej i interesuar të lobonte për të holla tek institucionet e Kosovës, ndërsa as Prishtina nuk ishte e entuziazmuar për të përkrahur një pjesë të popullatës serbe e cila kishte treguar se pikë së pari ishte besnike ndaj Serbisë dhe institucioneve paralele. Për pasojë, serbët e Shtërpces humbën hisen e tyre të 1.4 milionë eurove të fondeve për zhvillim.³⁵ Së fundmi, përfaqësuesit ndërkombëtarë kanë inkurajuar Prishtinën që të përfshijë serbët në projektet e tyre, kurse një projekt me vlerë prej 430,000 eurosh, i sponsorizuar nga Komisioni

Evropian, për ndërtimin e një sistemi për furnizim me ujë në Shtërpce, është i paraparë të fillojë në nëntor 2009.³⁶

III. ZGJEDHJA E LIDERSHIPIT TË RI KOMUNAL

Zgjedhjet lokale në Kosovë, të parapara për 15 nëntor 2009, ofrojnë shansin më të mirë për të përfunduar këtë duel në mes të komunave zyrtare dhe paralele dhe për t'i dhënë Shtërpces një pushtet lokal funksional për të cilin ka aq shumë nevojë.³⁷ Kjo më së shumti do t'i ndihmonte banorëve të saj, por do t'i ndihmonte edhe Serbisë dhe qeverisë së Prishtinës. Beogradi është çdo herë e më pak tolerant ndaj komunave paralele që kushtojnë dhe nuk janë efektive, pjesërisht sepse aty janë kryesisht të punësuar anëtarët e partive të cilat janë rreptësisht kundër koalicionit të tanishëm në Serbi.³⁸ Dhe një komunë e drejtuar nga serbët dhe duke operuar brenda kornizës në Kosovë do t'i ndihmonte Kosovës që të tregojë pjekurinë e saj drejt pavarësisë së plotë dhe të pambikëqyrur.

Mirëpo, të dyjat Serbia dhe Kosova janë duke e penguar themelimin e një komune efektive në Shtërpce. Beogradi ka frikë se çfarëdo pjesëmarrje zyrtare serbe në institucionet e Kosovës do të dobësonte rastin e saj kundër shpalljes së pavarësisë së Kosovës në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë (GjND), e planifikuar për dëgjim publik më 1 dhjetor 2009.³⁹ Pas bojkotimit të zgjedhjeve të fundit, të mbajtura nën mbikëqyrjen e OKB-së, Serbia nuk dëshiron të duket sikur po zbrapset duke i aprovuar këto zgjedhje në Kosovën e pavarur.⁴⁰ Heshurazi ajo ka hulumtuar mënyra për përcaktimin e përgjegjësisë një trupi neutral siç është Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) apo Këshilli i Evropës, por në mënyrë kategorike ka refuzuar të bash-

³³ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i komunës paralele, Shtërpce, dhjetor 2008. Vendet e punës ishin lajmëruar disa herë, pasi që pat raporte të nepotizmit dhe korrupsionit. Grupi i Krizave ishte dëshmitar i një radhe të punëkërkuesve të zemëruar, që ishin duke pritur të takoheshin me kryetarin e komunës gjatë seancës javore, gjatë së cilës kohë ai takohej me qytetarë.

³⁴ Një pjesë e përlëshjes kishte të bënte me statusin e katërm-bëdhjetë punëtorëve të objektit elektrik serb EPS në Shtërpce, të cilët të gjithë marrin 150 përqind të pagave të homologëve të tyre në Serbi, anipse nuk bëjnë asgjë përveç disa riparimeve të vogla. Intervistë me telefon e Grupit të Krizave, gazetar serb, Shtërpce, 29 korrik 2009.

³⁵ 1 milion euro nga ministria e transportit dhe 400,000€ nga burime të tjera qeveritare. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar qeveritar, Prishtinë, gusht 2009.

³⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, gusht 2009.

³⁷ Për më shumë detaje për zgjedhjet, shih "Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë", ["Report of the Secretary-General on the United Nations Interim Administration Mission in Kosovo"], UNSC S/2009/497, 30 shtator 2009.

³⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar qeveritar, Beograd, gusht 2009.

³⁹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar qeveritar serb, 25 qershor 2009. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së kërkoi mendimin këshillëdhënës nga GjND-ja më 8 tetor 2008, se "a është shpallja e njëanshme e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetë-qeverisjes në përputhje me të drejtën ndërkombëtare?" komunikatë për shtyp e GjND-së, 10 tetor 2008.

⁴⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar qeveritar serb, Beograd, 25 qershor 2009.

këpunojë me institucionet e Kosovës,⁴¹ ndërsa në qershor 2009 ka bërë thirrje për bojkot.

Prishtina nuk e konsideron decentralizimin – transferin e kompetencave drejt komunave dhe krijimin e disa komunave të reja me pakica – si prioritet të lartë. Qeveria e vështron këtë si shpërblim që nuk dëshiron t'ia bëjë këtë dhuratë serbëve të cilët vijojnë me bojkotin: Prishtina “nuk mund t'i japë pushtet njerëzve kur ekziston një nivel aq i lartë i jolojalitetit”, tha një zyrtar i lartë i qeverisë.⁴² Zyrtarë të lartë ndërkombëtarë kanë mirëkuptim për këtë pikëpamje, kështu që ka pak presion për zbatimin e kësaj pjese vitale të planit të Ahtisaarit.⁴³ Liderët e Kosovës janë gjithashtu të ndjeshëm ndaj çfarëdo ndryshimi në politika kundrejt Kosovës së veriut dhe enklavave të jugut të cilat, sipas pikëpamjes së tyre, mund të bëhen precedent për ndarje. Për këtë arsye, ata refuzojnë që të transferojnë kompetencat e theksuara Shtërpes para vënies nën kontroll të komunës së Mitrovicës.⁴⁴ Liderët shqiptarë të Shtërpes kanë rezervë për zgjarësinë e decentralizimit, duke dyshuar se kjo gjë do ta fundoste komunën në “një kaos dhe krizë më të thellë” duke shpërblyer serbët “jobesnikë”.⁴⁵

Beogradi dhe Prishtina e shikojnë Shtërpen nëpërmjet thjerrëzës së agjendave të tyre më të gjera, në veçanti të definimit të statusit të Kosovës. Çmimi i kësaj është lënja pas dore dhe mosfunksionimi në pushtetin komunal, gjë që është e dëmshme si për serbët ashtu edhe për shqiptarët. Prioritet duhet të jenë interesat e njerëzve të Shtërpes. Ata nuk duhet të mbahen në pritje derisa të dy kryeqytetet vazhdojnë betejën ligjore dhe diplomatike. Komuniteti ndërkombëtar në Kosovë mban një pjesë të përgjegjësisë që të sigurojë implementimin e suksesshëm të planit të Ahtisaarit. Zyra Civile Ndërkombëtare e saj (ZCN) ka kompetenca ekzekutive sipas ligjit të Kosovës, dhe duhet të bëjë presion në qeverinë e Kosovës që pa asnjë vonesë të implementojë decentralizimin në Shtërpe.⁴⁶ Njëkohësisht, Beogradi duhet të

inkurajohet që të mos bëjë hapa drejt imponimit të bojkotit, por që të përkrahë çfarëdo qeverie që del nga zgjedhjet lokale.

Ka nevojë për hapa konkrete, duke filluar nga transferi i kompetencave nga qeveria qendrore te komunat menjëherë pas zgjedhjeve të nëntorit. Decentralizimi ka disa komponente. Si komunë me shumicë serbe, Shtërpe duhet të ketë “kompetenca të theksuara komunale”.⁴⁷ Derisa këto duhet t'i transferohen të gjitha komunave me shumicë serbe atëherë kur ato të jenë të gatshme për to, Shtërpe është e pozicionuar në situatën më të mirë për të filluar këtë proces. Komuna duhet të ketë autoritet mbi shëndetësinë primare dhe sekondare, duke përfshirë kontrollin buxhetor dhe administrativ mbi objektet e tyre të këtij rajoni. Me tepicën e mjekëve, Shtërpe do të mund të bëjë qendër mjekësore rajonale e cila, megjithëse e shfrytëzuar pikë së pari nga serbët që jetojnë në rrethinë, do të mund dhe do të duhej t'i shërbente po ashtu edhe popullatës shqiptare dhe vizituesve të Brezovicës. Kontrolli administrativ do t'i lejonte komunës që të vendosë oraret për shërbimet mjekësore të aprovuara, të negociojë blerjen e tyre dhe të bëjë këtë financim nga fondet e Serbisë apo donatorët.⁴⁸ Për momentin këto çështje janë të rregulluara nga Prishtina (për klinikën shqiptare në Shtërpe) duke shfrytëzuar një proces të fshehtë të tenderimit.

Shtërpe gjithashtu duhet të ketë autoritet të plotë që të imponojë “tatime lokale, gjopa e dënime” dhe të vendosë mbi buxhetin e saj.⁴⁹ Duke pasur parasysh shumat e mëdha të parave që tashmë janë duke u investuar nëpërmjet komunës në Zonën e Vikendit, si dhe potencialin për investime edhe shumë më të mëdha në Brezovicë (shih më poshtë), ky është një pushtet i rëndësishëm. Me kohë, Shtërpe do të mund të bëjë e vetëqëndrueshme. Mirëpo për disa vite, ushtrimi i përgjegjësisë komunale në shëndetësi, arsim, mbrojtje të ambientit, ujësjellës, pastërti, mirëmbajtje të rrugëve dhe shërbime të tjera do të varehin nga fondet e jashtme.

⁴¹ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i ministrisë në Kosovë, prill/qershor 2009. OSBE-ja apo Këshilli i Evropës do të mund të organizonin zgjedhjet vetëm nëse kërkohet një gjë e tillë nga PSSP-ja. Kapaciteti i tij i zvogëluar dhe refuzimi i Prishtinës madje edhe për ta biseduar këtë, e bën një skenar të tillë jorealit.

⁴² Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 11 mars 2009.

⁴³ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, gusht 2009.

⁴⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i ministrisë së pushtetit lokal, Prishtinë, 20 gusht 2009.

⁴⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, Ali Halimi, zëvendëskryetar, Shtërpe, 10 qershor 2009.

⁴⁶ ZCN-ja mund të bëjë presion te qeveria “prapa dyerve të mbyllura” që të transferojë kompetencat e theksuara në Shtërpe. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, 2 shtator 2009. Një zyrtar ndërkombëtar bëri me dije se Përfaqësuesi

Civil Ndërkombëtar, Piter Fajt, s'para do të përdorë pushtetin e tij ekzekutiv, se mund të duket se po “i çon ujë mullirit të Beogradit në rastin e GjND-së”. Intervistë e Grupit të Krizave, Prishtinë, gusht 2009.

⁴⁷ “Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës” [“Comprehensive proposal for the Kosovo Status Settlement”], UNSC S/2007/168/Add.1, 26 mars 2007, Aneks 3, Neni 4. Dokumenti i Këshillit të Sigurimit përfshin atë që zakonisht quhet plani i Ahtisaarit. Shih po ashtu Raportin e Grupit të Krizave, *Integrimi i serbëve në Kosovë*, op. cit., f. 23-26.

⁴⁸ Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet ministrisë së Kosovës dhe klinikave serbe kanë dërguar deri te disa vonesa në transportime në rajonet serbe gjatë vitit 2008. “Blokirani lekovi” [“Ilaçet e bllokuara”], B92 (online), 28 gusht 2008.

⁴⁹ Propozimi gjithëpërfshirës, op. cit., Aneksi 3, Neni 8.

Qeveria e Kosovës duhet të ofrojë përkrahje për një kohë, ndërsa Serbia duhet të vazhdojë që të ofrojë para për shërbimet sociale, mirëpo jo nëpërmjet komunës paralele. Pushteti i Shtërpces duhet po ashtu të fuqizohet, në mënyrë që të kërkojë dhe të pranojë fonde nga donatorët për nevojat e veta dhe për projekte rajonale të koordinuara me komuna të tjera.

Asambleja komunale duhet të ketë kontroll efektiv mbi emërimin e komandantit të stacionit të Policisë së Kosovës.⁵⁰ Shkollat fillore dhe të mesme janë përgjegjësi komunale në tërë Kosovën, ndërsa në pjesët serbe mund të përdoren librat dhe planprogramet e mandatuara nga ministria e arsimit në Serbi.⁵¹ Implementimi i këtyre aspekteve të decentralizimit do të sigurojë që shkollat serbe të Shtërpces, klinikat dhe policia të mbesin ashtu siç kanë qenë – të udhëhequra nga serbët – dhe të largoheshin nga mbikëqyrja jollogaridhënëse dhe jofunktionale e komunës paralele, gjë që do të jetë me ndihmesë për banorët, si dhe për Prishtinën dhe Beogradin.

Qeveria qendrore e Kosovës duhet gjithashtu të delegojë përgjegjësi për regjistrimin dhe licencimin e bizneseve dhe të mbrojtjes së pyjeve. Shtërpce është tashmë përgjegjëse për përdorimin e tokës, në Zonën e Vikendit dhe në Brezovicë. Privatizimi i këtyre vendeve nuk mund të ecë përpara pa një plan valid për përdorimin e tokës, të krijuar nga ministria për ambient dhe planifikim hapsinor e Kosovës, dhe të aprovuar nga asambleja komunale.

Shtërpce mund të bëhet komunë të cilën edhe Prishtina edhe Beogradi mund ta konsiderojnë si legjitime, në qoftë se arrijnë që ta shikojnë nga prizmi i antagonizmit të ndërsjelltë. Rrjedhimisht, themelimi i një komune funksionale do të ndihmonte në krijimin e një elite politike lokale, e cila do të ndihej rehat që të merrej me të dyjat. Normalizimi i marrëdhënjëve dhe zbutja e tensioneve duhet të nisnin në nivelin lokal. Bllokada e tanishme është e përshtatshme vetëm për ata të cilët kanë kaluar vite të tëra në pozita kyçe, pa mandate apo llogaridhënie të qartë. As Serbia e as Kosova nuk nxjerrin benefite – e madje as përparësi retorike – nga status quo-ja. Shtërpce mund të bëhet model dhe lider për enklavat jugore dhe lindore, duke tërhequr projekte rajonale dhe duke siguruar që komunat e reja si Kllokoti e Ranillugu të mos vështrojnë vetëm në drejtim të veriut dhe Mitrovicës.

As administrata zyrtare e as ajo paralele nuk mund të përballojnë përgjegjësitë të cilat vijnë me decentral-

izimin. Për këtë arsye zgjedhjet e nëntorit janë shumë të rëndësishme. Një numër i partive të vogla serbe do të emërojnë kandidatë, ndërsa Iliqi, ish-kryetari i popullarizuar, kandidon si i pavarur. Disa grupe, si të rinjtë, të varfërit, dhe shumë të zhvendosur nga Prizreni dhe Ferizaj, janë të interesuar që të votojnë; të tjerët, duke përfshirë edhe shumë nga ata të cilët janë të varur nga pagat serbe, kanë më shumë hezitime. Shtërpce është një vend rural e disi i izoluar; të mirat e decentralizimit kuptohen dobët, ndërsa ekziston një frikë e theksuar e braktisjes nga ana e Serbisë. Një përpjekje e përbashkët nga akterët ndërkombëtarë dhe – në prapavijë – nga Prishtina për të sqaruar përparësitë konkrete dhe për të risiguruar serbët se votimi nuk do t'i rrezikojë lidhjet e tyre me Beogradin, do të mund të arrinte një ndryshim të vërtetë. Dalja në vota nuk do të jetë i madh, por me një përpjekje, do të jetë aq i madh sa që të prodhojë rezultate përfaqësuese. Nëse një numër i mjaftueshëm i serbëve votojnë për të shtyrë zgjedhjet deri te sondazhi, kandidati serb me siguri do të fitonte rundin e dytë.

Megjithatë, serbët e Shtërpces mund të bojkotojnë zgjedhjet, sidomos nëse Beogradi bën presion ndaj tyre. Në një rast të tillë, opsionet politike do të ishin mjaft të ndryshme. Qeveria e Kosovës do të preferonte që të lejonte marrjen e detyrës së kryetarit të komunës nga një shqiptar, por duke vazhduar mandatet e komunarëve serbë.⁵² Kjo do të ishte jo e ligjshme: qeveria nuk ka autoritet për të vazhduar mandatet.⁵³ Është e kuptueshme që shqiptarët e Shtërpces kanë mëri nga vazhdimet e së kaluarës, gjë që i privonte ata nga fitorja elektorale, mirëpo liderët shqiptarë e kuptojnë se duke pasur parasysh shumicën serbë në komunë, një qeveri efektive ka nevojë për një udhëheqje serbe.⁵⁴

Nëse do të ketë bojkot, do të ketë nevojë për emërimë ekzekutive. Në emër të qeverisë, ministria për pushtet lokal (MAPL) gjendet në pozitën më të mirë për të bërë këto emërimë; serbët e Kosovës janë marrur me të për vite me radhë dhe janë të familjarizuar me të. Kështu, në rast të një bojkoti, ministria duhet të fillojë duke konsultuar komunitetin lokal, në mënyrë që të identifikojë kandidatët

⁵² Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i lartë i MAPL-it, 4 shtator 2009. Së pari PSSP-ja, pastaj qeveria aplikuan këtë politikë në Novobërdë në korrik 2008.

⁵³ Vazhdimi i mëparshëm i qeverisë i mandatit të kryetarit të komunës së Shtërpces ishte në kundërshtitë të qartë me Ligjin e Kosovës për zgjedhjet lokale, Neni 11, dhe Ligjin e Kosovës për vetëqeverisje lokale, neni 50, por u duk i domosdoshëm për shkak të mungesës së zgjidhjeve të tjera të problemit.

⁵⁴ Nëse qeveria emëron një kryetar serb pas bojkotit të serbëve, si përshkruhet më poshtë, kandidati udhëheqës shqiptar në teori mund të apelojë te Komisioni për Zgjedhje; pasi që me gjasa ai apo ajo do t'i takonte PDK-së, një gjë e tillë sigurisht nuk do të ndodhë.

⁵⁰ Nën propozimin gjithëpërfshirës, në rajonet serbe asambleja komunale propozon dy kandidatë te ministria e brendshme e Kosovës, e cila pastaj vendosë për njërin/njëren; Aneksi 8, Neni 2.6.

⁵¹ Propozimi gjithëpërfshirës, Aneksi 3, Neni 7.

me kredibilitet dhe përkrahje të fortë, dhe të formojë një konensus rreth emërimeve, të shoqëruar me një fushatë për të treguar të mirat e bashkëpunimit. Kjo duhet të ndihmohet nga avokimet e ndërkombëtarëve për të inkurajuar Beogradin që të japë pëlqimin për pjesëmarrjen e serbëve lokalë. Pastaj, një kryetar të ri komune nga mesi i kandidatëve të regjistruar serbë do të duhej të zgjedhej, që të punojë si administrues i përkohshëm dhe të emërojë kryesuesit e departamenteve.

MAPL duhet gjithashtu të emërojë anëtarët e një asambleje të përkohshme nga lista e kandidatëve serbë. Nëse bojkoti është i pjeshëm, emërimet duhet të jenë pak a shumë në proporcion me rezultatet zgjedhore, dhe duke marrë parasysh shkathtësitë dhe përvojën. Këta anëtarë serbë të asamblesë pastaj do të duhej të punonin me anëtarët e tyre të zgjedhur shqiptarë. Në qoftë se këto rrethana speciale thërrasin për emërimet të tilla të pozitive ekzekutive, prioritet do të duhej të ishte ndërtimi i një pushteti sa më të mirë, e jo përmbajtja në mënyrë strikte e përqindjeve. Sidoqoftë, kryesuesit e departamenteve dhe asambleja duhet të reflektojnë përbërjen etnike të Shtërpces.

Një nga detyrat e para të administratës duhet të jetë largimi i komunës paralele nga zyra e kryetarit të komunës. Është e rëndësishme që administrata ta bëjë këtë vetë, pa përfshirjen e Prishtinës apo organizatave ndërkombëtare, në mënyrë që të dërgojë një sinjal të qartë se nuk do të jetë letargjike sikur pararendësja e saj. Hapi i dytë duhet të jetë largimi i posterëve nga ndërtesa e komunës ku paraqitet lideri i partisë SRS Vojislav Sheshel, i cili është në gjykim për krime lufte në Hagë. Dukja e një strukture komunale, e përkushtuar për të punuar për interesat e Shtërpces dhe me mekanizmat për të arritur qëllimet e saj, është mënyra më e mirë për të ndryshuar mendjet e lokalëve që bojkotojnë zgjedhjet. Komuna paralele mund të bëhet irelevante vetëm nëse komuna e re zyrtare fillon të zgjidhë problemet e përditshme të njerëzve. Me ndikimin e minimizuar të komunës paralele, Beogradi do të përballej me një vendim pragmatik se ç'të bëjë me një strukturë të madhe e cila nuk i shërben ndonjë qëllimi.

Komuniteti ndërkombëtar në Kosovë dhe zyrtarët në Prishtinë nuk janë duke e bërë prioritet Shtërpçen. Derisa misioni i OSBE-së është duke monitoruar të dyja komunat, nuk ekzistojnë shumë ide se si të zgjidhen problemet. Oferta për një decentralizim të përshtetshëm për Shtërpçen nuk është opsion, pasi që Prishtina heziton që të shpërblejë Shtërpçen derisa të jetë shpërbërë komuna paralele, dhe derisa ndërkombëtarët që merren me decentralizimin janë të fokusuar në ndërtimin e komunave të reja. "Fokusi nuk është në Shtërpce", tha një zyrtar ndërkombëtar. "Fokusi është që të arrijmë në nivelin e njëjtë të zhvillimit administrativ të Kllokotit

dhe Ranillugut si të atij në Shtërpce".⁵⁵ Derisa autoritetet zyrtare të komunës janë të interesuara që decentralizimi t'u japë kompetenca, zyrtarët paralel thonë në mënyrë sfiduese, "ne qysh tani kemi më shumë kontroll dhe fonde sesa që mund të na ofrojë decentralizimi".⁵⁶ Mirëpo, kriza e vazhdueshme në Beograd rreth buxhetit të Serbisë tregon se ato fonde s'para do të jenë aty për një kohë edhe të gjatë.

IV. BREZOVICA

Qendra për skijim Brezovica është resursi më i rëndësishëm ekonomik në Kosovën jugore. Vend alternativ gjatë Lojërave Olimpikë Sarajeva 1984, potenciali i saj e kalon atë të rajoneve më shumë të njohura, si ai i Banskos së Bullgarisë.⁵⁷ Gjatë kulmit të suksesit të saj, ky vend ishte mikpritës i 120,000 mysafirëve për qëndrime të shkurtra, rreth gjysma e tyre gjatë sezonës së skijimit dhe gjysma në verë, atëherë kur rudinat alpinike dhe përrrenjtë e saj janë ideale për ecje.⁵⁸ E vendosur në përpjetën e malit të Sharrit dhe përbrenda parkut nacional, mendohet se Brezovica ka disa nga rrëshqitjet më të larta të skijimit në Evropë.⁵⁹ Është një orë rrugë nga aeroportet e Shkupit dhe të Prishtinës, të dyja këto të shërbyera me fluturime të lira, dhe kështu të pozicionuara mirë për tregun e sporteve ndërkombëtare dimërore.

Vendi turistik është në gjendje të keqe fizike, e koklavitur në mesin e përleshjes mbi pronësinë ndërmjet Serbisë dhe Kosovës, që është gati një dekadë e vjetër. Tri hotelet e saj të vogla janë të vjetërsuara; njëri është duke u për-

⁵⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, Shtërpce, 23 maj 2009. Kllokot-Vërboc dhe Ranillug janë dy nga pesë komunat e reja me shumicë serbe, të propozuara nën decentralizim. Kllokoti-Verboci do të përfshijë fshatrat dhe rajonet serbe rreth Vitisë; Ranillugu do të bëhet qendra e fshatrave serbe në veri të Gjilanit dhe rreth Kamenicës. Komunat e tjera janë Parteshi, i cili përfshin kryesisht rajonet serbe në jug të Gjilanit; Veriu i Mitrovicës; Graçanica (duke përfshirë pjesë të Fushë Kosovës, Lipjanit dhe Prishtinës) dhe komuna e zgjeruar e Novobërdës, duke përfshirë fshatrat serbe në veri të Kamenicës dhe perëndimit të Gjilanit.

⁵⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i komunës paralele, Shtërpce, 17 korrik 2009.

⁵⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, kontraktues që merret me privatizimin e qendrës së skijimit, Shtërpce, 20 maj 2009.

⁵⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, Aleksandar Janiqeviq, kryetar i qendrës për skijim të Inex-it Brezovica, Shtërpce, 22 maj 2009.

⁵⁹ Mali ka 30 km të vendeve për skijim, në mes 1,700 dhe 2,500 metra mbi nivelin e detit, me një lëshim maksimum prej 804 metrave; vende të reja për skijim mund të zhvillohen në afërsi. Mesatarisht 128 ditë në vit janë të përshtatshme për skijim. Shih www.brezovica-ski.com/sr/brezovica-40.

dorur si bazë nga paqeruajtësit e NATO-s (KFOR), dhe tjetri përdoret për strehim të personave të zhvendosur dhe për zyra të disa kompanive serbe. Ndërtimi i hoteleve të reja sigurisht do të ishte më i lirë sesa renovimi i atyre ekzistuese.⁶⁰ Ashensorët (liftat) për skijim, të ndërtuara nga kontraktuesit gjermanë dhe zviceranë në vitet e '80-a, janë ndryshkur deri në atë masë sa që të mos jenë më të sigurt. Edhepse askush nuk është lënduar deri më tani, ata shpesh nuk funksionojnë si duhet dhe bllokohen.⁶¹ Një numër i vogël i vizituesve, gati të gjithë nga Kosova, shkojnë ende atje, por kjo gjeneron të ardhura të mjaftueshme për të mbarëvajtur 240 punëtorët e këti vendi turistik, të cilët shpesh nuk paguhen me muaj me radhë.⁶²

Privatizimi, çelësi i të ardhmes së vendit turistik dhe prosperitetit të Shtërpces, është bllokuar për gati një dekadë nga përlëshja e komplikuar që përfshin disa kompani serbe, kontraktuesit e tyre lokalë, UNMIK-un dhe qeveritë e Kosovës dhe të Serbisë. Esenca e kësaj përlëshjeje është politike, mirëpo ligjërisht aty kyçet raporti në mes të kompanisë serbe që pretendon pronësinë, Inex, dhe dega e saj në Shtërpce. Kjo e fundit u regjistrua si ndërmarrje me pronësi shoqërore – kategori e veçantë e korporatave kjo nën socializmin jugosllav – në Ferizaj më 1954.⁶³ Të gjitha këto ndërmarrje në Kosovë mund t'i nënshtrohen privatizimit nga autoritetet lokale, fillimisht nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) të cilën e themeloi UNMIK-u në vitin 2002, dhe tani nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), organ i pavarur ky me pjesëmarrje ndërkombëtare.⁶⁴

Mirëpo Beogradi thekson se INEX-i po ashtu e ka regjistruar qendrën e skijimit Brezovica si pronën e saj korpo-

orative në një gjykatë të Beogradit në vitin 1973,⁶⁵ gjë që do t'i jepte Serbisë jurisdiksion.⁶⁶ Zyrtarët serbë thonë se INEX-it tashmë e ka shitur një pjesë të pronës së saj gjetiu në Kosovë, dhe argumentojnë se kjo vendosë një precedent që duhet të përcillet edhe në Brezovicë.⁶⁷ Ish-kryetari i komunës Iliq beson se është e kotë që dikush të mundohet të përcaktojë pronarin e vërtetë: “UNMIK-u shpenzoi dhjetë vjet duke hulumtuar për një përgjigje, por pa e gjetur atë”.⁶⁸

Të dyjat, AKM-ja dhe Serbia kanë lansuar përpjekje të hershme për të shitur vendin e skijimit, por kanë dështuar. AKM-ja kishte marrë aprovimin nga selia e OKB-së dhe kishte publikuar reklama në revista si *The Economist*, por ka tërhequr ofertat pas tërheqjes së aprovimit.⁶⁹ Agjencia e Privatizimit nga Serbia e hapi tenderin e saj në qershor 2006 por e tërhoqi në të njëjtin vit pas një presioni të madh nga OKB-ja.⁷⁰ Serbia mund të kundërshtojë një përpjekje të re nga AKP-ja, por kjo nuk duhet të ndalojë tenderin. Nëse Inex-i beson se të drejtat e saj mbi pronën janë injoruar, mund ta dërgojë rastin në dhomën speciale të Gjykatës Supreme të Kosovës e cila merret me raste të privatizimit, dhomë kjo që ka gjykatës ndërkombëtar.

Procesi i privatizimit duhet të jetë transparent për popullatën lokale. Punëtorët e Brezovicës shpresojnë për një kompenzim të madh parash – ligji i Kosovës u jepë të drejtën e 20 përqindshes të çmimit të blerjes.⁷¹ Banorët dhe zyrtarët lokal të pyetur nga Grupi i Kri-

⁶⁰ Intervista të Grupit të Krizave, vëzhgues qeveritar/ndërkombëtar, Shtërpce/Beograd, maj 2009.

⁶¹ Intervista të Grupit të Krizave, vizitues të Brezovicës, Prishtinë/Shtërpce, maj/qershor 2009.

⁶² Intervistë e Grupit të Krizave, Aleksandar Janiqeviq, kryetar i qendrës për skijim të Inex-it Brezovica, Shtërpce, 22 maj 2009.

⁶³ Është e regjistruar si ndërmarrje me pronësi shoqërore, INEX SAR-PLANINA, Brezovicë, Gjykata komerciale, Fi – 699/89, 27 dhjetor 1989.

⁶⁴ Plani i Ahtisaarit, i cili formon bazën për pavarësinë e Kosovës dhe i cili është inkorporuar në ligjin e Kosovës, shpjegon se e tërë prona e Serbisë brenda Kosovës t'i kalohet Kosovës (neni 8.3), dhe rregullon privatizimin e ndërmarrjeve me pronësi shoqërore me të drejtën për të apeluar te dhoma e veçantë e Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila përbëhet prej një shumice gjykatësish ndërkombëtar. Propozimi gjithëpërfshirës, op. cit., Aneksi 7, Neni 2; “Mbi themelimin e dhomës së veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës mbi çështjet e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” [“On the Establishment of a Special Chamber of the Supreme Court of Kosovo on Kosovo Trust Agency related matters”], Rregullorja e UNMIK-ut 2002/13. AKP-ja mori përsipër asetet dhe përgjegjësitë e AKM-së në vitin 2008.

⁶⁵ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i Inex Interexport, Beograd, 4 qershor 2009; Dr. Nenad Popoviq, *Otvoreno o Ekonomiji Kosova i Metohije* [Haptazi rreth ekonomisë së Kosovës e Metohisë], (Beograd, 2008), f. 274.

⁶⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i Inex Interexport, Beograd, 4 qershor 2009. Në fakt, dy partnerë të Inex-it – Inex Interexport dhe Inex Hotels – plus zyra lokale në Shtërpce kanë pretendime mbi qendrën e skijimit.

⁶⁷ Po aty.

⁶⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, Slagjan Iliq, Shtërpce, 21 maj 2009.

⁶⁹ Paul Acda, ish-kryesuesi i AKM-së, i tha Grupit të Krizave se Beogradi i kishte bërë presion Departamentit të OKB-së për Operacione Paqeruajtëse, e cila në momentin e fundit e kishte udhëzuar UNMIK-un që të anulojë tenderët. Intervistë, Prishtinë, qershor 2009. Grupi i Krizave ka parë disa komunikime kablllore nga OKB-ja të cilat autorizojnë privatizimin e Brezovicës. Inex dhe zyrtarët serbë besojnë se përpjekjet e dështuara tregojnë dyshime serioze në OKB për pronësinë e Brezovicës. Intervista të Grupit të Krizave, Shtërpce dhe Beograd, maj deri në korrik 2009.

⁷⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, Paul Acda, ish-kryesuesi i AKM-së, Prishtinë, qershor 2009. Një politikan serb në Shtërpce i tha Grupit të Krizave se përlëshjet brenda koalicionit qeveritar serb dhe interesat komerciale të anëtarëve të saj, kontribuan në dështimin e përpjekjeve për privatizim. Intervistë e Grupit të Krizave, Shtërpce, 21 maj 2009.

⁷¹ Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13, Neni 10.1; Udhëzimi administrativ mbi punëtorët me të drejta pune Nr. 2005/12, Pjesa 4.1.

zave, presin që privatizimi të mbledhë në mes 20 milionë euro dhe 50 milionë euro neto; madje edhe shuma e vogël do t'i sillte secilit punëtor një kompenzim të barabartë me disa herë pagën vjetore mesatare të tyre.⁷² Këto pritje mund të jenë jorealiste pasi që çmimi i blerjes do të varet shumë nga detajet e tenderit dhe sidomos nga kërkesat e investimit dhe lejet për përdorimin e tokës. Normalisht, operatorët e vendit të skijimit marrin paga më të larta nga zhvillimi dhe shitjet e vendbanimeve sesa nga hoteli apo aktivitetet në pista.⁷³ Lejet komunale për të ndërtaur njësite rezidenciale në rajonin e skijimit do të kishin ndikim të madh në çmime. Ekspertët ndërkombëtarë vlerësojnë se qendra për skijim mund të ketë nevojë për investime me vlerë prej më shumë se 100 milionë eurosh për t'u bërë I realisuashëm dhe qenë I qëndrueshëm, dhe s'para do të mund të bënte profit në pesë vitet e para.⁷⁴

Privatizimi i suksesshëm do të mund të shiste këtë vend për një çmim të nominuar, më ç'rast blerësi do të përkushtohet për investime të mëdha dhe krijime të vendeve të punës me anë të zhvillimeve të pronave. Kjo do të mund të revitalizonte rajonin dhe të hapte deri në 500 vende të reja pune, duke absorbuar pjesën dërrmuese të papunësisë së Shtërpces, por do të linte punëtorët e tanishëm pa bonuset për të cilat ata shpresojnë.⁷⁵ Në këtë rajon ku rrëfimet për privatizim të korrumpuar dhe për viktimizim të punëtorëve janë të shpeshta, kjo paraqet rrezik. Në mënyrë që të shmanget dëmtimi i kredibilitetit të brishtë të qeverisë, procesi i privatizimit duhet të përfshijë takime dhe konsultime me komunitet dhe punëtorët e qendrës së skijimit. Kërkesat se fuqia punëtoare duhet të reflektojë përzierjen etnike lokale dhe se blerësi duhet të jetë një operator me përvojë i qendrave të skijimit, pranohen gjerësisht nga të gjitha anët dhe duhet të qëndrojnë si të tilla.

⁷² Për këtë arsye, punëtorët e qendrës së skijimit preferojnë një çmim të lartë blerës pa investime të mëpastajme apo krijime të vendeve të punës, sesa çmim të ulët me përfitime më të mëdha afat-gjata. Intervista të Grupit të Krizave, punëtorët e qendrës së skijimit, Shtërpce, maj-korrik 2009.

⁷³ Intervistë e Grupit të Krizave, Kirk Adams, ish-drejtor i AKM-së, Prishtinë, 1 qershor 2009. Zyrtarët serbë i kanë thënë Grupit të Krizave se vetëm privatizimi i hotelëve nuk do të "bënte më shumë sesa një euro". Intervista, zyrtarë të qendrës së skijimit Brezovica, dhe ministria serbe për ekonomi dhe zhvillim rajonal, Shtërpce, Beograd, maj-qershor 2009.

⁷⁴ Intervistë e Grupit të Krizave, kontraktues ndërkombëtar, Shtërpce, maj/korrik 2009.

⁷⁵ Intervista të Grupit të Krizave, ekspert ndërkombëtar për privatizim, Shtërpce, maj/qershor 2009. Disa kompani ndërkombëtare që kanë shfaqur interesim në Brezovicën, kanë ofruar deri në 3,000 vende të reja pune në rajon. Intervistë e Grupit të Krizave, Paul Acda, ish-kryesues i bordit të AKM-së, qershor 2009.

Hapi i parë drejt privatizimit i përket ministrisë së ambientit dhe planifikimit hapsinor të Kosovës e cila, si u tha më lartë, duhet të adaptojë një plan për përdorimin e tokës në këtë rajon. Ka nevojë edhe për aprovimin e komunës.⁷⁶ Për arsye se Brezovica është e vendosur brenda parkut nacional, vendimet se çka mund të ndërtohet janë të ndjeshme për ambientin si dhe ekonomikisht të rëndësishme. Plani duhet të lejojë për një numër të mjaftueshëm të ndërtimeve që do të bënte qendrën makinë të zhvillimit, por pa bërë dëme të tepërta në një nga vargmalet më të paprekura të rajonit. Ministria duhet të veprojë shpejt: ajo ka draft plane, të përgatitura nga Instituti i saj për Planifikim Hapsinor, të cilat sigurisht do të pranohen pa ndryshime të mëdha.⁷⁷ Ajo gjithashtu do të duhej të pastrojë hedhurinat e vendosura në skajet e rrugës, të cilat infektojnë përrrenjtë e maleve. Komuna paralele tregon interes të pakët në këtë, mirëpo ndihma nga Prishtina do të përmirësonte raportet në mes të banorëve, serbëve dhe shqiptarëve.⁷⁸

AKP-ja, e entuziazmuar që të privatizojë Brezovicën, është duke bërë përgatitje, duke përfshirë edhe zhvillimin e "Zonës Turistike të Brezovicës", e cila pritet të përfundojë në fund të vitit 2010,⁷⁹ dhe është duke i koordinuar punët me komunën nëpërmjet dy zyrtarëve të vendosur në Shtërpce.⁸⁰ Institucionet serbe refuzojnë që të punojnë me AKP-në, ashtu njëjtë si me të gjitha organet qeveritare të Kosovës, dhe vazhdojnë të theksojnë pohimet e tyre për pronësi.⁸¹ Mirëpo, organizatat e mëdha të cilat janë të përfshira këtu – Komisioni Evropian dhe Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) – e kon-

⁷⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar i ministrisë, Prishtinë, gusht 2009.

⁷⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, konsulent ndërkombëtar për privatizim, Shtërpce, 20 maj 2009.

⁷⁸ Intervista të Grupit të Krizave, zyrtar i komunës paralele, Shtërpce, 21 maj 2009; profesor universitar dhe aktivist për ambient, Shtërpce, 23 maj 2009.

⁷⁹ Intervista të Grupit të Krizave, Dino Hasanaj, kryetar, bordi i drejtorëve, Shkëlzen Lluka, drejtor, koordinimi rajonal, AKP, Prishtinë, 19 gusht 2009.

⁸⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, Dino Hasanaj, kryetar, bordi i drejtorëve, AKP, Prishtinë, 19 gusht 2009.

⁸¹ Në prill 2008, Inex formoi një ndërmarrje të përbashkët me operatorin publik serb për skijim, duke pasur pretendime mbi Brezovicën dhe duke premtuar investime të mëdha; "Sudbina Brezovice Biće Odredjena u Narednih Nekoliko Meseci" ["Fati i Brezovicës të vendoset në disa muajt e ardhshëm"], *Danas*, 10 mars 2008. Asgjë nuk është ndërtaur përveç një segmenti të shkurtër rrugor; asnjë nga të ardhurat nuk janë paguar që nga marsi 2009. Intervista të Grupit të Krizave, punëtorët e qendrës së skijimit, Shtërpce, maj/qershor 2009. Serbia ka folur për një "privatizim joformal" nën mbikëqyrjen e saj; këshilltar i ministrit për ekonomi dhe zhvillim ekonomik Dinkiq, Beograd, 3 qershor 2009; eksperti ndërkombëtar për privatizim, Shtërpce, qershor 2009.

siderojnë AKP-në si institucionin e vetëm me autoritetin e nevojshëm për të privatizuar Brezovicën.⁸²

Nuk ka alternativë praktike.⁸³ Serbisë i mungon kapaciteti për të zbatuar vendimet në lidhje me shitjen e Brezovicës. Inex-i mundet dhe duhet të regjistrojë brengat e veta fillimisht me AKP-në dhe, nëse është e domosdoshme, me dhomën e veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës. Të dy organet kanë pjesëmarrje të konsiderueshme ndërkombëtare, kështu që të punosh me to nuk ka nevojë që kjo të nënkuptohet si njohje e pavarësisë së territorit. Kontaktet me AKP-në mund të bëhen në mënyrë joformale, kështu që edhe Prishtina edhe Beogradi duken se janë të hapura ndaj diskutimeve diskrete.⁸⁴ Shumica e gjykatësve të dhomës së veçantë madje nuk janë as kosovarë. Inex-i dhe qeveria serbe duhet të njohin faktin se në qoftë se mundohen që të vonojnë apo të pengojnë privatizimin, kjo mund të dëmtojë serbët e Shtërpces shumë më shumë sesa ndoshta qeverinë e Kosovës.

V. ZONA E VIKENDIT

Zona e Vikendit – rajon ky i kasolleve dhe vilave legale, gjysmë-legale dhe thjesht ilegale afër Brezovicës dhe brenda parkut nacional të Sharrit – është gjithashtu vitale për të ardhmen e Shtërpces. Në të kaluarën koleksion i disa shtëpizave për pushim për elitën komuniste të Kosovës dhe Jugosllavisë, ajo është bërë simbol i korrupsionit politik dhe jokapacitetit komunal, dhe kështu kërcënon që të dëmtojë raportet përndryshe të qeta ndër-etnike në Shtërpce. Rivënia e rendit në Zonë duhet të jetë prioritet i lartë në agjendën e pushtetit lokal.

Problemet filluan në 1970-a, kur autoritetet komunale vendosën që të ekspropriojnë tokën që çon në Brezovicë dhe ta shndërrojnë atë në zonë ekskluzivisht të pushimit për elitën politike.⁸⁵ Në teori, pronarët serbë qenë paguar për tokën, por shumë nga ta pohojnë të mos kenë marrur aspak të holla, ose të kenë marur pak, e disa thonë se as nuk ishin konsultuar. Këto pohime janë ende duke u shqyrtuar – shumë ngadalë – në gjykatat e Kos-

ovës.⁸⁶ Tokat iu dhanë figurave të njohura nga të gjitha pjesët e Jugosllavisë, përfshirë këtu edhe shumë anëtarëve të elitës shqiptare kosovare.⁸⁷ Kjo provokoi mëri tek serbët për atë që disa serbë të Shtërpces ende e konsiderojnë si “orvatje për shqiptarëzimin e një rajoni që kishte qenë plotësisht serb”.⁸⁸ Në vitet e 1970-a dhe 1980-a, rregullat kufizonin ndërtimet në Zonën e Vikendit në 50 metra katrorë maksimum, shtëpiza këtu shumë të vogla me ndikim minimal në ambient.⁸⁹

Lufta e viteve 1998-1999 shkatërroi Zonën e Vikendit: gati e tërë prona e shqiptarëve u djeg. Por banorët filluan të kthehen dhe të rindërtojnë në vitin 2001, dhe shpejt u bë e qartë se rregullat e vjetra nuk mund të zbatoheshin më tej. Një valë ndërtimesh të reja – të gjitha ilegale – shpërtheu në tërë rajonin. Disa pronarë vendosën struktura dhjetë herë më të mëdha sesa madhësia origjinale; të tjerët ndërtuan hotele të vogla apo restorane.⁹⁰ Sot janë më shumë se 300 shtëpi në Zonë, dhe megjithë rregullave të UNMIK-ut që ndalojnë shitjet, shumë sosh kanë kaluar nëpër duar të ndryshme.⁹¹ Elita e re e Kosovës – politikanë dhe intelektualë të njohur shqiptarë dhe ish-luftëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – tashti janë pronarë të shumë prej tyre.⁹² Një lider lokal shqiptar tha se ai “nuk do të ishte i befusuar nëse qeveria të mbante mbledhjet e veta në Zonën e Vikendit”.⁹³

Shtirirja ilegale e ndërtimeve të reja është ende duke vazhduar.⁹⁴ As komuna zyrtare e as ajo paralele nuk kanë

⁸² Intervistë e Grupit të Krizave, Fabio Serri, kryesues i zyrës së BERZh-së, Prishtinë, 13 gusht 2009.

⁸³ Institucionet e njohura nga Serbia dhe Kosova, si EULEX-i, hezitojnë që të involvohen. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Prishtinë, gusht 2009.

⁸⁴ Intervista të Grupit të Krizave, Beograd, Prishtinë, maj-gusht 2009.

⁸⁵ Shtërpce dhe Brezovica atëbotë ishin pjesë e komunës së Ferizajt.

⁸⁶ “TV Danas i Sutra – Vikend Zona na Brezovica” [“TV Sot dhe Nesër – Zona e Vikendit në Brezovicë”], 29 qershor 2007, www.unmikonline.org/pio/tv/scripts/danas_i_sutra/290607.htm.

⁸⁷ Intervistë e Grupit të Krizave, pronar boshnjak në Zonën e Vikendit, Prishtinë, 15 qershor 2009.

⁸⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, politikan serb nga Kosova, Shtërpce, 22 maj 2009.

⁸⁹ Vetë toka nuk u shit; banorët janë pronarë vetëm të shtëpive. Intervista të Grupit të Krizave, pronarë në Zonën e Vikendit, Shtërpce/Prishtinë, maj-qershor 2009.

⁹⁰ Ish-kryetari i komunës Slagjan Iliq i tha Grupit të Krizave se administrata e tij ishte e paafte për të ndaluar ndërtimet. Intervistë, Shtërpce, 21 maj 2009.

⁹¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyra komunale për kadastra, Shtërpce, 21 maj 2009. “Mbi regjistrimin e kontratave për shitjen e pronës reale në rajone gjeografike specifike të Kosovës”, Rrgullorja e UNMIK-ut 2001/17.

⁹² Nexhat Daci, ish-kryetar i Kuvendit të Kosovës, është i kthyeri më i njohur në Zonën e Vikendit.

⁹³ Intervistë e Grupit të Krizave, Shtërpce, 10 qershor 2009.

⁹⁴ Zyrtarët komunalë i kanë treguar Grupit të Krizave një dokument që thotë se 66 objekte të reja kishin filluar apo mbaruar në mes të korrikut 2008 dhe marsit 2009. Komuna zyrtare pohon se vetëm njëmbëdhjetë shtëpi ishin ndërtuar para se komuna paralele mori punën në dorë. Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar komunal, Shtërpce, maj 2009. Kryetari i komunës paralele Zvonko Mihajloviq i tha Grupit të Krizave se disa nga strukturat e ndërtuara kohëve të fundit

mundur të zbrapsin këtë rritje, dhe nuk është e qartë nëse edhe kanë provuar shumë.⁹⁵ Thashethëmet për mito sillen gjithkrah dhe, në ca raste, duken se kanë bazë të saktë. Raportohet se vetë zyrtarët e lartë në zyrën e kadastritës kanë prona ilegale në Zonë.⁹⁶ Tre biznesmenë të njohur shqiptarë kosovarë i kanë thënë Grupit të Krizave se kishin hequr dorë nga ndërtimi i shtëpive në pronat e veta, edhe pse e kishin tërë dokumentacionin përkatës, sepse zyrtarët e komunës u kërkonin mito prej 700 euro deri në 1,200 euro.⁹⁷ Mungesa e kapacitetit është problem aq sa edhe korrupsioni. Një zyrtar ndërkombtar, i cili është pronar i një prej shtëpizave origjinale e të pazgjeruara, ishte munduar që të marrë aprovimin për riparime, por i kishin thënë thjesht që t'i "japë mito gardianëve të postbllokut" kur të bënte transferimin e materialit ndërtimor, sepse komuna nuk kishte njerëz për të gjetur dokumentet e nevojshme për të lëshuar leje.⁹⁸

Vënja e rendit në Zonën e Vikendit nuk do të jetë punë e lehtë, madje edhe për një pushtet të ri komunal. Shumë zyrtarë nga Shtërpce kanë punuar për një nga administratat që është provuar të ndalë rritjen e Zonës, me mungesë suksesi që ka mundur të jetë i qëllimshëm. Kredibiliteti i tyre është i dobët. Madje edhe me qëllimet më të mira, komunës mund t'i mungojë kapaciteti që të administrojë rajonin në mënyrë transparente e me rend. Të dy kryetarët e komunës, anipse refuzojnë që të

kishin filluar para se ai të vinte në detyrë; ai fajësoi "mungesën e resurseve dhe pengesat nga komuna tjetër" për paaftësinë e administratës së tij për të kontrolluar Zonën. Intervistë e Grupit të Krizave, Shtërpce, 21 maj 2009.

⁹⁵ Më 31 korrik 2008, zyrtarët e komunës paralele vendosën postbllok në rrugën që çon në Zonën e Vikendit, duke thënë se nuk lejoheshin që makinat e ndërtimit të shkonin tutje. "Brana anarhiji i nelegalnoj gradnji" ["Barrierë anarkisë dhe ndërtimeve ilegale"], Glas Javnosti, 8 gusht 2008. Kjo pati efekt të vogël: Grupi i Krizave pa material ndërtimor që kalonte andej disa herë gjatë majit-qershorit 2009, dhe ish-zyrtari i postbllokut tha se qëllimi i vetëm i tij ishte që "të mirreshin ekstra mito nga ata që ishin duke ndërtuar në Zonën e Vikendit". Intervistë e Grupit të Krizave, Shtërpce, 22 maj 2009. Mirëpo, një gazetar i pavarur serb tha se ndërtimet "qartazi u ngadalësuan" nën administratën paralele gjatë kohës kur postblloku ishte operacional. Intervista të Grupit të Krizave, Shtërpce, maj-qershor 2009. Policia e Kosovës mori përsipër postbllokun pa ndonjë rezistencë më 14 korrik 2009.

⁹⁶ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Shtërpce, maj 2009. Grupi i Krizave vëzhgoi punën që bëhej për të zhvilluar një vend terracë për një restorant në Zonën e Vikendit, pronë e një zyrtari komunal.

⁹⁷ Intervista të Grupit të Krizave, pronarë në Zonën e Vikendit, Prishtinë, qershor 2009.

⁹⁸ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Shtërpce, maj 2009.

bashkëpunojnë me njëri tjetrin, pajtohen se misioni i Bashkimit Evropian për rendin e ligjit (EULEX) duhet të marrë problemin nga duart e tyre.⁹⁹ Vëzhguesit ndërkombëtarë theksojnë se komuna nuk ka ndërmarrë asgjë nga konkluzionet e një studimi të OSBE-së mbi ndërtimet ilegale të viteve 2003 dhe 2004.¹⁰⁰ Mungesa e një zgjidhjeje mund të jetë e përshtatshme për të dy palët, sepse lejon vazhdimin e profitit nga kaosi.¹⁰¹ Me siguri se kjo i konvenon elitës së Prishtinës.

Komuna ka nevojë për ndihmë që të vendosë rend në Zonën e Vikendit pas votës së nëntorit. Staf i MAPL-it duhet të koordinojë punët me qeverinë dhe Agjencinë Kadastrale të Kosovës, për të ndihmuar zyrën e kadastrës që të vendosë rregull dhe të ndërtojë kapacitetet për lëshimin e lejeve me kohë dhe në mënyrë transparente. MAPL-i duhet të punojë me komunën e re dhe të finalizojë planin për përdorimin e tokës për rajonin e Brezovicës dhe Zonën e Vikendit, që përcakton se çfarë llojesh të strukturave mund të ndërtohen dhe të zgjerohen, gjë që do të ruante më së shumti parkun nacional nga zhvillimi.¹⁰² Prioritet duhet të jetë ndalimi i ndërtimeve të reja ilegale në Zonë.

Ndërtesat ekzistuese ilegale nuk duhet të shkatërrohen. Shumë nga pronarët janë politikisht të fuqishëm; rrëzimi i vilave të tyre do të tensiononte situatën dhe do ta bënte më të vështirë kthimin në një jetë normale për Shtërpçen. Në vend të kësaj, komuna duhet të përdorë autoritetin e saj që të imponojë tatime lokale dhe gjoba strikte, të kategorizuara në bazë të madhësisë dhe shpenzimeve të shtëpisë. Pronarëve që paguajnë duhet t'u legalizohen pronat.¹⁰³ Të ardhurat nga legalizimi do të ishin të mirëseardhura për komunën e Shtërpçes; madje edhe taksë modeste mbi pronën në Zonë do t'ia jepte një nxitje buxhetit të qytezës. Prishtina dhe Zyra Civile Ndërkombëtare do të duhet të ofrojnë përkrahje politike. Një pushtet komunal i udhëhequr nga një serb nuk do të mund të përballej vetëm me pronarët e fuqishëm shqiptarë. EULEX-i duhet ta bëjë të qartë se do të përdorë autoritetin e vet për të ndjekur korrupsionin, nëse

⁹⁹ Intervista të Grupit të Krizave, Shtërpce, maj 2009. Të dy kryetarët e komunës refuzuan që të punojnë drejt gjetjes së një zgjidhjeje.

¹⁰⁰ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Shtërpce, 21 maj 2009.

¹⁰¹ Intervistë e Grupit të Krizave, zyrtar ndërkombëtar, Shtërpce, Beograd, qershor-korrik 2009.

¹⁰² Sharri është parku më i madh nacional i Kosovës dhe figuron thekshëm në përputhje me programet e BE-së si Natura 2000 dhe Emerald Network, të cilat kërkojnë që parqet nacionale të jenë të mbrojtura dhe të ndëshkohen të gjitha aktivitetet ilegale atje.

¹⁰³ Ligji që do të legalizonte strukturat e ngritura pa leje është duke u diskutuar për momentin.

Shtërpce dhe qeveria e Kosovës nuk mund të implementojnë rregullin e ligjit në Zonën e Vikendit.¹⁰⁴

Dhe ndoshta edhe më me rëndësi, një veprim i tillë do të dërgonte një sinjal të serbët e Shtërpces se ata vetë mund të zgjidhin problemet të cilat i rëndojnë më së shumti, mbi të gjitha mungesën e ligjit në Zonën e Vikendit, si dhe korrupsionin dhe ndërtime të paplanifikuara të cilat po shkatërrojnë ambientin natyral të komunës së tyre.¹⁰⁵

VI. PËRFUNDIM

Shtërpce i ofron Kosovës shpresën më të mirë për të themeluar një komunë me shumicë serbe që është plotësisht funksionale e me prosperitet, dhe kështu të dëshmojë se serbët mund të sigurojnë interesat e tyre brendapërbrenda kornizës kushtetuese të Kosovës. Pjesa dërrmuese e banorëve janë të vendosur të qëndrojnë, ushqejnë pak iluzione për ndarje apo kthim nën sundimin serb dhe shkojnë mirë me fqinjët e tyre shqiptarë; komuna ka një optimizëm që është i rrallë në mesin e enklavave serbe të Kosovës. Mund të jetë një rol model shumë i vyeshëm për komunat e reja të cilat janë të mandatuara nga plani i Ahtisaarit dhe të cilat priten të krijohen në vitin 2010. Përndryshe, dështimi në Shtërpce do të mund të kishte pasoja të errëta. Është vështirë të shihet se si decentralizimi dhe integrimi i serbëve mund të ketë sukses diku tjetër, nëse nuk ka sukses atje. Vazhdimësia e një qeverisjeje të ndarë dhe joefektive do të dëmtonte më së shumti banorët e saj, por gjithashtu do të dërgonte dridhje nëpër të gjitha enklavat dhe në veri.

Serbia duhet ta ketë relativisht lehtë që të përkrahë këtë proces, pasi që pjesa më e madhe e asaj që është duke bërë për serbët e Shtërpces nuk është kontraverze dhe duhet të vazhdojë edhe pas zgjedhjeve. Ndajja e përkrahjes për strukturat paralele do të kursente para dhe do të kushtonte më pak. Në të njëjtën kohë, është e qartë se Beogradi nuk ka kapacitete që të ofrojë shërbime të gjera qeveritare në Shtërpce: banorët e saj janë të varur nga fqinjët kosovarë dhe nuk mund të mbështeten krejtësisht në administratën serbe, veprimet e së cilës nuk njihen askund tjetër. Serbia as nuk mund të ofrojë rend të ligjit. Nëse ajo zgjidhë që të pengojë pushtetin e ri komunal, ajo do të sakrifikoje shqetësimet ekzistenciale të serbëve të Shtërpces.

Qeveritë e Kosovës dhe të Serbisë, si dhe komuniteti ndërkombëtar, secila për shkak të arsyeve të veta, e kanë lënë anash Shtërpçen. Me gjithë premtimet e mëdha që posedon komuna, ajo nuk është prioritet i asnjëres. Kjo duhet të ndryshojë. Detyra urgjente është përkrahja e pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet e nëntorit 2009 dhe, nëse dalja në vota është e pakët, të emërohet një administratë multi-etnike e udhëhequr nga një serb. Kryetari i ri i komunës pastaj do të ketë nevojë për ndihmë për të ndërtuar kapacitetet e komunës për të administruar vetveten. Kosova, Beogradi dhe komuniteti ndërkombëtar, të gjitha duhet të ndihmojnë.

Decentralizimi është ende një abstraksion për serbët e Kosovës, të cilët kanë dëgjuar shumë premtime por kanë parë pak përfitime nga komuniteti ndërkombëtar dhe qeveria e Kosovës. Shumë dyshojnë se Prishtina nuk është me të vërtetë e përkushtuar për mirëqenjen e tyre. Tejkallimi i mosbesimit të serbëve mund të arrihet vetëm me anë të përfitimeve të kapshme në jetën e përditshme – pushtet përgjegjës të udhëhequr nga banorët lokalë, shërbime komunale dhe rritje ekonomike, të ofruara në vazhdimësi. Asnjë komunë nuk është në pozitë më të mirë për të filluar këtë proces sesa Shtërpce.

Prishtinë/Bruksel, 15 tetor 2009

¹⁰⁴ Përforsimi i dënimeve është problem anekënd Kosovës, gjë që e bën vitale përkrahjen politike nga qeveria dhe EULEX-i.


¹⁰⁵ Intervista të Grupit të Krizave, banorët e Shtërpces, maj-gusht 2009.

ANEKS A

HARTA E KOSOVËS DHE KOMUNITETET SËRBE



Produced by Crisis Group



New Serb-Majority Municipalities Under The Ahtisaari Plan

Other Serb-Majority Areas